[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
 [Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

## “OFRIMI I SHËRBIMIT ONLINE PËR MONITORIMIN E TRAFIKUT”

### Përfituesi / Autoriteti Kontraktues

Bashkia e Tiranës/ Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor.

### Hyrje

Një shërbim i besueshëm dhe cilësor në internet është një domosdoshmëri absolute për Qendrën e Monitorimit të Trafikut TOCC. Kërkesat janë të larta, shërbimi shumë kritik dhe ndërprerjet janë të patolerueshme.

Qendra e Monitorimit të Trafikut e cila menaxhohet nga Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, me adresë Rr. “Myrtezim Këllici”, pranë Gjimnazit Profesional Ekonomik, ka në administrimin e saj 75 kryqëzime semaforike (NUTC), 67 kamera survejimi (CCTV) në kryqëzimet më të rëndësishme të Tiranës, nga të cilat 55 janë në të njëjtën vendndodhje me kryqëzimet semaforike.

Pikat në të cilën do të ofrohet shërbimi duhet të jenë Dark fiber, të lidhura me Qendrën e Monitorimit të Bashkisë Tiranë, ku gjithashtu të gjitha këto pika do të kenë shërbim interneti të dytë (backup), që do të realizohet nëpërmjet 86 SIM Card, ku do të aktivizohet shërbimi DATA 3G/4G/LTE, për të patur shërbim pa ndërprerje.

Këto pika do të jenë në monitorim nga Sistemi i menaxhimit të sistemeve të trafikut urban (T- UTC), që mbulon të gjithë territorin urban të qytetit të Tiranës dhe ka si qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve urbane.

### INFRASTRUKTURA E RRJETIT DHE NDËRLIDHJA

Bashkia e Tiranës nëpërmjet kësaj kontrate kërkon të plotësohen kushtet teknike për ofrimin e shërbimit sipas kërkesave të paraqitura në këtë dokument.

**Shërbimi Online për Sistemin e monitorimit dhe menaxhimit të sistemeve të trafikut urban TOCC me lidhje Dark Fiber.**

Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka përdorimi i ndërlidhjes së internetit si mjet furnizues për Qendrën e Monitorimit të Trafikut me shërbim Interneti/intraneti dhe ***lidhja e internetit backup me 86 Data SIM Card me shpejtësi 3G/4G/LTE***, është parë e arsyeshme që shërbimet e internetit dhe 3G/4G/LTE të trajtohen si shërbime kritike dhe nuk do të tolerohet ndërprerja e shërbimit. Pra, lidhjet duhet të bëhen në mënyrë redundante me 86 Data SIM Card (High Available) për të siguruar një shërbim të vazhdueshëm dhe cilësor 24 orë /24 orë në 7 ditë të javës.

### 1. Shërbim Interneti për Drejtorinë e Transportit dhe Trafikut Rrugor (Qendra e Monitorimit të trafikut)

Drejtoria e Transportit dhe Trafikut Rrugor do të pajiset me linjë interneti të dedikuar, me anë të teknologjisë fiber optike, Wireless, xDSL ose ekuivalente.



**Tabela 1 \_ Situata Aktuale**

| NR | Pika  | Adresa  | Sherbimi Internet |
|----|---|---|-------------------|
| 1  | Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, (Qendra e Monitorimit të Trafikut) | Rruga Myrtezim Këllici pranë Gjimnazit Profesional Ekonomik | 20Mbps/20Mbps     |

Për linjën Dark Fiber e cila do të terminohet në Drejtorinë e Transportit e Trafikut Rrugor, (Qendra e Monitorimit të Trafikut), nevojiten 8 IP publike, të cilat do jenë të përfshira në vlerën totale të kontratës.

Nisur nga arsyet teknike mbi realizimin e shërbimit të internetit, me qëllim që linja që përdor Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, (Qendra e Monitorimit të Trafikut) të jetë redundante, është kusht i domosdoshëm, që operatori ekonomik të ofrojë brenda vlerës totale të kontratës, dhe një linjë fizike backup nga një tjetër rrugë në mënyrë që të mos ketë shpërbim shërbimi në asnjë moment, për të cilën nevojiten gjithashtu 4 IP publike.

## **2. Sistemi i monitorimit dhe menaxhimit të sistemeve të trafikut urban TOCC melidhje Dark Fiber + Data SIM Card**

Më poshtë jepet lista e pikave për të cilat kërkohet shërbim nëpërmjet kësaj kontrate.

Pikat/vendndodhjet e mëposhtme do të kenë lidhje Dark Fiber me Qendrën e Monitorimit të Bashkisë Tiranë. Këto lidhje do të realizohen me anë të Fibrës Optike (Dark fiber) dhe do të terminohen në ndërfaqe optike të cilat ndodhen në Bashkinë e Tiranës, konkretisht tek Drejtoriae Transportit e Trafikut Rrugor me adresë tek Rr.“Myrtezim Këllici” pranë Gjimnazit Profesional Ekonomik. Topologjia e rrjetit për lidhjet e mëposhtme do të përcaktohet nga Operatori Ekonomik.

**Tabela 2 \_ Situata Aktuale**

| Nr . | Emertimi | Vendndodhja          | CCTV                  | Shërbimi me fibër Optike | Afati/ Ditë |
|------|----------|----------------------|-----------------------|--------------------------|-------------|
| 1    |          | Sheshi Willson       | CCTV06                | Dark Fiber               | 731 ditë    |
| 2    | NUTC8    | Banke- Muze          | CCTV 8.1 & CCTV 8.2   | Dark Fiber               | 731 ditë    |
| 3    | NUTC9    | Hotel Dajti          | CCTV 9.1 & CCTV 9.2   | Dark Fiber               | 731 ditë    |
| 4    | NUTC10   | Shkolla Vasil Shanto | CCTV 10.1 & CCTV 10.2 | Dark Fiber               | 731 ditë    |
| 5    | NUTC11   | Tajvani              | CCTV 11.1 & CCTV 11.2 | Dark Fiber               | 731 ditë    |
| 6    | NUTC12   | Rr. Ndre Mjeda       | CCTV12                | Dark Fiber               | 731 ditë    |
| 7    | NUTC14   | Ura Teknologjike     | CCTV14                | Dark Fiber               | 731 ditë    |

|    |         |  |                          |            |          |
|----|---------|--|--------------------------|------------|----------|
| 8  | NUTC15  | 21 Dhjetori                              | CCTV15                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 9  | NUTC16  | Unaza-M.Shyri                            |                          | Dark Fiber | 731 ditë |
| 10 | NUTC17  | Ura Rr. Elbasanit                        | CCTV 17.1 &<br>CCTV 17.2 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 11 | NUTC18  | Liceu                                    | CCTV18                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 12 | NUTC19  | RTSH                                     | CCTV19                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 13 | NUTC20  | Ministria e Drejtesise                   | CCTV20                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 14 | NUTC21  | Libri Universitar                        | CCTV21                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 15 | NUTC22  | Presidenca                               | CCTV22                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 16 | NUTC23  | Kryeministria                            | CCTV23                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 17 | NUTC24  | Ministria Rendit                         | CCTV24                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 18 | NUTC25  | Gjykata e Larte                          | CCTV25                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 19 | NUTC26  | INSIG                                    | CCTV26                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 20 | NUTC27  | Ushtari Panjohur                         | CCTV27                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 21 | NUTC28  | Shkolla Bajram Curri                     | CCTV28                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 22 | NUTC29  | Rr. Kont Urani                           | CCTV29                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 23 | NUTC30  | Inxhinieria Ndertimit                    | CCTV30                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 24 | NUTC31  | Stadiumi Dinamo                          | CCTV31                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 25 | NUTC32  | Rr. Abdyl Frasherri-Rr.<br>Vaso Pasha    | CCTV32                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 26 | NUTC33  | Rr. Komuna Parisit                       | CCTV33                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 27 | NUTC34  | Ministria Arsimit                        | CCTV34                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 28 | NUTC35  | ATSH                                     | CCTV 35.1 &<br>CCTV 35.2 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 29 | NUTC36  | Rr. Mine Peza                            | CCTV36                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 30 | NUTC37  | Drejtoria e Policise                     | CCTV 37.1 &<br>CCTV 37.2 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 31 | NUTC38  | Sheshi Kombinat                          | CCTV38                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 32 | NUTC39  | Rr. Qelqit                               |                          | Dark Fiber | 731 ditë |
| 33 | NUTC40  | Shkolla e Gjuheve te<br>Huaja            | CCTV40                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 34 | NUTC41  | Shkolla Qemal Stafa                      |                          | Dark Fiber | 731 ditë |
| 35 | NUTC42  | Shkolla Misto Mame                       |                          | Dark Fiber | 731 ditë |
| 36 | NUTC 43 | Bulevardi Ri/Filip Jano                  |                          | Dark Fiber | 731 ditë |
| 37 | NUTC44  | Ish Ekspozita                            |                          | Dark Fiber | 731 ditë |
| 38 | NUTC45  | Rr. Irfan Tomini/ Blv.<br>Gjergj Fishta  | CCTV45                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 39 | NUTC46  | Rr. Khanfize Keko /<br>Rr. Sadik Petrela | CCTV46                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 40 | NUTC47  | Rr. Kavajes / Rr 3<br>Deshmoret          | CCTV47                   | Dark Fiber | 731 ditë |
| 41 | NUTC48  | Laprake                                  | CCTV48                   | Dark Fiber | 731 ditë |

|    |        |   |        |            |          |
|----|--------|---|--------|------------|----------|
| 42 | NUTC52 | Rruga Lord Bajron /<br>Rr. Pandi Dardha |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 43 | NUTC53 | Unaze / Rr. Don Bosko                   | CCTV53 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 44 | NUTC54 | Unaze / Rr. Jordan<br>Misja             | CCTV54 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 45 | NUTC55 | Unaze / Blv. Zogu Pare                  | CCTV55 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 46 | NUTC56 | Unaze / Rr.<br>Barrikadave              | CCTV56 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 47 | NUTC57 | Unaze / Rr. Siri Kodra                  | CCTV57 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 48 | NUTC58 | Unaze / Rr. 5 Maji                      | CCTV58 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 49 | NUTC59 | Unaze / Rr. Dibres                      | CCTV59 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 50 | NUTC60 | Unaze / Rr. Kongresi<br>Manastirit      | CCTV60 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 51 | NUTC61 | Unaze / Rr. Hoxha<br>Tahsim             | CCTV61 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 52 | NUTC62 | Brryli                                  | CCTV62 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 53 | NUTC63 | Bulevardi<br>Ri/Lokomotiva              |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 54 | NUTC64 | Rr. Kavajes / Rr. Besim<br>Alla         | CCTV64 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 55 | NUTC66 | Kupola                                  | CCTV66 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 56 | NUTC67 | Zogu Pare / Rr. Dedë<br>Gjon Luli       | CCTV67 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 57 | NUTC68 | Selvia                                  | CCTV68 | Dark Fiber | 731 ditë |
| 58 | NUTC69 | QSUT                                    |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 59 | NUTC70 | Rr. Ali Demi / Rr.<br>Hasan Sufa        |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 60 | NUTC71 | Ura Ministria e Jashtme                 |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 61 | NUTC72 | Ura Kisha Katolike                      |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 62 | NUTC73 | Ura UET                                 |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 63 | NUTC74 | URa Gjykata e Tiranës                   |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 64 | NUTC75 | Pallati Sportit Asllan<br>Rusi          |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 65 | NUTC76 | Blloku<br>Gintash                       |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 66 | NUTC78 | Qendra Globe                            |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 67 | NUTC80 | Konferenca e<br>Pezes/Rr.Bego<br>Hoxha  |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 68 | NUTC81 | Konferenca e Pezes/Rr.<br>Bubulina      |        | Dark Fiber | 731 ditë |
| 69 | NUTC82 | Ura Hotel Hilton                        |        | Dark Fiber | 731 ditë |

|    |  |   |                       |                     |          |
|----|--|---|-----------------------|---------------------|----------|
| 70 | NUTC83                                     | Ish Policia Bashkiake /<br>Rr.Kavajes                             |                       | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 71 | NUTC84                                     | Rr. Xhanfize Keko-<br>Rr.Zihni<br>Sako                            |                       | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 72 | NUTC85                                     | Bulevardi Ri/Karl Gega  |                       | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 73 | NUTC86                                     | Marteniteti i<br>Ri   |                       | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 74 | NUTC87                                     | Bulevardi<br>Ri/SotirPolena                                       |                       | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 75 | NUTC88                                     | Bulevardi Ri/Siri<br>Kodra  |                       | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 76 | NUTC99                                     | Blv. Petronini Luarasi /<br>Rr. Todi Shkurti                      |                       | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 77 |  | Diga e Liqenit  | CCTV89                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 78 |  | Kopshti Zoologjik   | CCTV91.1&CCTV<br>91.2 | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 79 |  | Kristal   | CCTV93                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 80 |  | Rrethi Komuna Parisit   | CCTV94                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 81 |  | Komisariati nr. 4   | CCTV95                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 82 |  | Rr. Kastriotet<br>(Euroteorema)                                   | CCTV96                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 83 |  | Zogu i Zi   | CCTV97                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 84 |  | Mbikalimi Unazes<br>Fabrika e Miellit                             | CCTV13                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 85 |  | Rr. Elbasanit   | CCTV03                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 86 |  | IKV   | CCTV04                | Dark Fiber          | 731 ditë |
| 87 | Qendra e<br>Monitorim<br>it të<br>Trafikut | Rruga Myrtezim Këllici<br>pranë Gjinnazit<br>Profesional Ekonomik |                       | 86 data SIM<br>Card | 731 ditë |

**Tabela 2 .1\_ Situata e Pritshme**


Përgjatë kohëzgjatjes së kontratës mund të nevojiten lidhje të reja për të cilat do të fillojë ofrimi i shërbimit sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, sipas specifikimeve më poshtë:

| Nr. | Emërtimi                            | Sasia e Pritshme | Shërbimi Internet | Afati i pritshëm/<br>Ditë |
|-----|-------------------------------------|------------------|-------------------|---------------------------|
| 1   | Shërbim<br>Interneti/intraneti      | 20               | Dark Fiber        | 181 ditë                  |
| 2   | Qendra e Monitorimit të<br>Trafikut | 20               | Sim Card          | 181 ditë                  |

Të gjitha pikat do të lidhen fizikisht me Dark Fiber me zyrën e Drejtorisë së Transportit e Trafikut Rrugor me adresë tek Rruga “Myrtezim Këllici” pranë Gjinnazit Profesional Ekonomiksipas kushteve të përcaktuara në këtë dokument. Topologjia e rrjetit për lidhjet e mëposhtme dotë përcaktohet nga Operatori Ekonomik.


### **Përshkrimi i Rrjetit**

Për Qendrën e Monitorimit, pikat kryesore të rrjetit të nyjeve semaforike dhe kamerave tregohen në diagramën e mëposhtme:



Përshkrimi i rrjetit të backup-it.

Zgjidhja teknike ( Ring Last Mile) do jetë primar **Dark Fibër** dhe back up **3G/4G/LTE**.



**Figure 240: Backup communication network architecture.**

### Skema llogjike e rrjetit backup

#### Karakteristikat e Rrjetit

Shërbimet e specifikuara më sipër duhet të sigurohen, menaxhohen dhe të plotësojnë indikatorë cilësisë të detajuara më poshtë:

#### Indikatorët e cilësisë.

- Për të gjitha pikat/vendndodhjet të ketë mundësi rialokimi sipas kërkesave të Bashkisë Tiranë.
- Për pikat: Tabela 2\_Situata aktuale dhe Tabela 2 .1\_ Situata e Pritshme, rrjeti primar duhet të jetë i bazuar me transmetim Dark Fiber nëntokësor .
- Për pikat: Tabela 2\_Situata aktuale dhe Tabela 2 .1\_ Situata e Pritshme, rrjeti Data Sim Card duhet të jetë i bazuar mbi teknologjinë 3G/4G/LTE në mënyrë që të jetë totalisht i pavaruar nga rrjeti primar.

#### Indikatorë të përgjithshëm.

- Për të gjitha IP publike të kërkuara, të realizohet mbrojtje ndaj sulmeve DDoS dhe SYN Attack.
- Rrjeti i Operatorit duhet të jetë i mbrojtur në nivel backbone.
- Rrjeti i ofruar duhet të garantojë full-duplex data transmission connection.
- Rrjeti duhet të jetë i sigurt, i mbrojtur dhe me parametra teknike që të sigurojnë shërbime për transmetime multimediale data, voice video.
- Rrjeti në shërbim të Bashkisë Tiranë, duhet të jetë i dedikuar dhe Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë lejet e nevojshme.

- Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e mirëmbajtjes së vazhdueshme (Marrëveshjen SLA) për tërë kohëzgjatjen e kontratës.
- Topologjia e rrjetit do të përcaktohet nga Operatori Ekonomik.

### **Instalimet e Rrjetit**

- Mënyra e ofrimit të shërbimit për kartat SIM për lidhjen Sim Card (Lidhje Backup), sipas Tabelës 2 dhe 2.1 të jetë me transmetim 3G/4G/LTE.
- Mënyra e ofrimit të shërbimit për rrjetin primar të tabelës 2 dhe 2.1 të Qendrës së Monitorimit të Trafikut do të jetë me transmetim Dark Fiber.
- Kapaciteti i kartave 3G/4G/LTE për shërbimin back-up duhet të jetë unlimited.
- Rrjeti duhet të jetë transparent ndaj mekanizmave QoS të niveleve të tjera që mund të aplikojë vetë përdoruesi.

### **Funksionimi i Rrjetit**

1. Shërbimi duhet të ofrohet 24/7 (24 orë në 7 ditë të javës).
2. Rrjeti i ofruar duhet të lejojë të përdoren software dhe hardware në funksion të aplikimeve që do të përdorë Bashkia Tiranë
3. Rrjeti duhet të jetë virtualisht i izoluar nga rrjetet e përdoruesve të tjerë.

### **Monitorimi i rrjetit**

Operatori duhet të ofrojë shërbimin “HelpDesk”. Ky shërbim konsiston në mirëmbajtjen e rrjetit, asistencë online për të gjithë problemet me rrjetin. Shërbimi Help Desk duhet të jetë i kontaktueshëm nga stafi i Bashkisë 24/7.

Konstatimi dhe riparimi i difekteve në linjë dhe/ose në pajisje që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi brenda afateve të mëposhtme:

- Koha e përgjigjes duhet të jetë brenda 10 minutash.
- Koha e zgjidhjes së problemit në të gjithë rrjetin fizik internet dhe Dark Fiber, duhet të jetë brenda 48 orësh, ndërsa për Data SIM Card, duhet të jetë brenda 3 orësh.
- Mbështetje aktive në institucion deri në zgjidhjen e problemit.

### **Mirëmbajtja e rrjetit**

- Për çdo problem të mundshëm apo riparim që do të bëjë Operatori përkatës, duhet të lajmërojë minimumi 1 (një) ditë para ndërprerjes.

### **Raportimi**

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë raporte teknike mujore (në mënyrë elektronike ose hard copy) ku do të përshkruajë:

- 
- Raportin dhe detajimin e veprimeve të ndërmarra në rrjet, zgjidhjen e problemeve (detajimi i të gjitha defekteve dhe zgjidhjeve që janë aplikuar), për shërbimin e internetit.

### **Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit**

Afati kohor i ofrimit të shërbimit "Tabela 1 dhe 2, Situata Aktuale", do të jetë për një periudhë kohore rreth 2 (dy) vjet / 731 (shtatëqind e tridhjetë e një ) ditë, duke filluar nga data eaktivizimit të shërbimit.

Faturimi i shërbimit për çdo pikë/vendndodhje (*Situata aktuale, Situata e Pritshme*) do të realizohet për sa kohë vendndodhja do të ketë shërbim aktiv. Në rast se ndonjë nga vendndodhjet/ pikat nuk do të duhet të jetë më aktive (në ofrimin e shërbimit) me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, vendndodhja /pika respektive nuk do të vijojë të faturohet nga operatori ekonomik.

Periudha e implementimit/aktivizimit të shërbimit për "Tabela 1 dhe 2, Situata Aktuale dhe Tabela 2.1 Situata e Pritshme" do të jetë deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Faturimi do të fillojë në momentin që shërbimi do të jetë aktiv për secilën vendndodhje, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor.



---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### **Shërbimi që kërkohet: Ofrimi i shërbimit online për Monitorimin e Trafikut**

Afati kohor i ofrimit të shërbimit “Tabela 1 dhe 2, Situata Aktuale“, do të jetë për një periudhë kohore rreth 2 (dy) vjet / 731 (shtatëqind e tridhjetë e një ) ditë, duke filluar nga data e aktivizimit të shërbimit.

Afati kohor i ofrimit të shërbimit “Situata e Pritshme Tabela 2.1“, do të jetë për një periudhë kohore rreth 181 ditë (njëqind e tetëdhjetë e një) ditë, duke filluar nga data e aktivizimit të shërbimit.

Faturimi i shërbimit për çdo pikë/vendndodhje (Situata aktuale, Situata e Pritshme) do të realizohet për sa kohë vendndodhja do të ketë shërbim aktiv.

Në rast se ndonjë nga vendndodhjet/ pikat nuk do të duhet të jetë më aktive (në ofrimin e shërbimit) me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, vendndodhja /pika respektive nuk do të vijojë të faturohet nga operatori ekonomik.

Periudha e implementimit/aktivizimit të shërbimit për “Tabela 1 dhe 2, Situata Aktuale dhe Tabela 2.1 Situata e Pritshme“ do të jetë deri në 30 (tridhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Faturimi do të fillojë në momentin që shërbimi do të jetë aktiv për secilën vendndodhje, brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor.

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Ofrimi i shërbimit online për Monitorimin e Trafikut”**

*Bashkia e Tiranës nëpërmjet kësaj kontrate kërkon të plotësohen kushtet teknike për ofrimin e shërbimit online për Sistemin e monitorimit dhe menaxhimit të sistemeve të trafikut urban TOCC me lidhje Dark Fiber. Duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka përdorimi i ndërlidhjes së internetit si mjet informimi, detyrimin për të furnizuar Qendrën e Monitorimit të Trafikut me shërbim Interneti/intraneti dhe lidhja e internetit backup me 79 Data SIM Card me shpejtësi 3G/4G/LTE, shërbimet e internetit dhe 3G/4G/LTE të trajtohen si shërbime kritike dhe nuk tolerohet ndërprerja e shërbimit. Pra, lidhjet duhet të bëhen në mënyrë redundante me 79 Data SIM Card (High Available) për të siguruar një shërbim të vazhdueshëm dhe cilësor 24 orë /24 orë në 7 ditë të javës. AK ka përcaktuar kërkesat minimale teknike për zërat e kërkuar në dokumentin e termave të referencës, në mënyrë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të mund të njihen me to dhe AK të garantohet se kontrata do të përmbushet sipas kushteve dhe kriterëve të kërkuara. Specifikimet janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara. Termat e referencës dhe kërkesat funksionale janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.*

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

#### **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës përkatësisht 83.325.452 (tetëdhjetë e tre milion e treqind e njëzet e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kontratës objekt prokurimi. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

---

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar pranë regjistrimit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit objekt kontrate. Për të vërtetuar këtë kërkesë, operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën/Autorizimin përkatës.

**2.3.3** Operatori duhet të jetë i regjistruar në RIPE. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të regjistrimit pranë RIPE NCC.

**2.3.4** Operatori duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë mbi përdorimin e Aksesit Global në Internet.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

a) Standardin ISO 9001 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

b) Standardin ISO 27001 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

c) Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 20000-1 ose ekuivalent, (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*

**2.3.6** Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit në të gjitha vendndodhjet e kërkuara, duhet të përmbushë minimalisht kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin tekniko-profesional punonjës të certifikuar si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CCNA Certified Network Associate Routing & Switching ose ekuivalente;
- b) Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CS PS Core Network Planning, ose ekuivalente;
- c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar SCTE ose ekuivalente.

*Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.*

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikata për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik (emer, mbiemër) / profilin e punonjësve (tipin e certifikatave përkatëse);
- Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi.

---

*Shënim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Në vijim Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentacionin provues sipas përcaktimit të bërë në këtë kriter.*

**Shënim: a.** *OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.*

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

**b.** *Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik” “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”*

**c. Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:**

- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.*
- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softwerike.*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi   | Përgjigjja |
|--|------------|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE) | -----      |
| Numri NIPT/et:   | -----      |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar  | -----      |
| Përfaqësuesi (emri):   | -----      |
| Telefoni:  | -----      |
| E-mail:  | -----      |

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

| Emri i nënkontraktorit të propozuar | NIPT -i | Përqindja e nënkontraktimit | Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar |
|-------------------------------------|---------|-----------------------------|---|
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |
|                                     |         |                             |   |

- Informacione për nënkontraktorin

